



QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
NATIONAL BUSINESS CENTER

KRIJIMI DHE ZHVILLIMI I QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (QKB)



ONE STOP SHOP

www.qkb.gov.al

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	01
Krijimi i QKR	02
Krijimi i QKL	04
Lindja e QKB-së	06
Procedurat pas bashkimit	07
Nga sportelet tek sistemi online	08
Përshtatja me legjislacionin e BE-së	09
Përfundim	10



Hyrje

01

Reformat ekonomike në Shqipëri gjatë viteve 2000 synuan krijimin e një administrate publike më efikase, transparente dhe të përafruar me standardet e Bashkimit Europian (BE).

Në këtë kuadër, lindja e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) përfaqëson një nga transformimet më të rëndësishme institucionale, e cila solli bashkimin e dy strukturave pararendëse: Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL).

www.qkb.gov.al



**Shërbime
100% Online**



Krijimi i QKR



Krijimi i QKR Qendrës Kombëtare të Regjistrimit



QKR u krijua me Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Kjo reformë kishte për qëllim thjeshtimin e procesit të regjistrimit të subjekteve tregtare dhe eliminimin e procedurave të gjata dhe të fragmentuara.




● Procedurat para QKR

- Regjistrimi bëhej pranë gjykatës.
- Subjekti tregtar regjistrohej gjithashtu në administratën tatimore, në INSTAT dhe në institucione të tjera.
- Procedura kërkonte disa javë kohë dhe dokumentacion të shumtë.

● Procedurat në QKR

- Të gjitha hapat u unifikuan në një sportel unik.
- Sipërmarrësi mernte ekstraktin tregtar brenda 1-3 ditësh.
- U ngrit një regjistër kombëtar elektronik i aksesueshëm nga publiku.



Krijimi i QKL



Krijimi i QKL Qendrës Kombëtare të Licencimit



QKL u ngrit me Ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë". Qëllimi i saj ishte unifikimi i procedurave për dhënien e licencave dhe reduktimi i fragmentimit institucional.




● Procedurat para QKL

- Bizneset aplikonin në disa institucione përkatëse.
- Nuk kishte afate të qarta dhe procesi shpesh ishte i pasigurt juridikisht.

● Procedurat në QKL

- Aplikimi kryhej në një sportel të vetëm ose online.
- U vendosën tre kategori licencash: me miratim automatik, me miratim të heshtur dhe me miratim të posaçëm.
- QKL bashkërendonte institucionet, duke garantuar afate dhe përgjegjësi të qarta.



06

Lindja e QKB-së



Në vitin 2015 u miratua Ligji nr. 131/2015, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i cili parashikoi bashkimin e dy institucioneve pararendëse. Kjo reformë kishte për synim të krijonte një sistem unik për regjistrimin dhe licencimin e bizneseve.



www.qkb.gov.al

Procedurat pas bashkimit


07



- Regjistrimi dhe licencimi kryheshin në një institucion të vetëm.
- U unifikuan regjistrat dhe bazat e të dhënave.
- Bizneset fituan akses të shpejtë dhe të thjeshtë në të gjitha shërbimet e nevojshme.

Benefitet:

Eliminim i mbivendosjes së kompetencave, reduktim i kohës, rritje e transparencës dhe efikasitetit.



Zhvillimi i shërbimeve - Nga sportelet tek sistemi online

Një nga prioritetet kryesore të QKB-së pas themelimit ishte dixhitalizimi i plotë i shërbimeve.

- Fillimisht, aplikimet bëheshin vetëm pranë sporteleve fizike.
- Me kalimin e kohës, u krijua platforma online për regjistrim, ndryshime statutore dhe aplikim për licenca.
- Sot, shumica e shërbimeve ofrohen në mënyrë elektronike, duke mundësuar aplikim dhe marrje dokumentesh pa pasur nevojë për kontakt fizik me sportelet.

Benefitet: akses 24/7, eliminim i korrupsionit, shpejtësi më e madhe dhe lehtësi për investorët vendas e të huaj.



Përshtatja me legjislacionin e BE-së



www.qkb.gov.al


Harmonizim me Direktivën e BE-së për shërbimet (2006/123/EC) dhe me direktivat për regjistrat tregtarë.

Përgatitje për integrim në Sistemin e Regjistrave të Biznesit të BE-së (BRIS).

Dixhitalizimi i plotë i shërbimeve në përputhje me praktikat më të mira europiane.


Rritja e transparencës dhe shkëmbimi ndërkombëtar i informacionit mbi bizneset.

09



Përfundim

Nga krijimi i QKR-së për thjeshtimin e regjistrimit, tek ngritja e QKL-së për menaxhimin e licencave, dhe deri tek bashkimi i tyre në QKB me shërbime tërësisht online, ky evolucion institucional ka transformuar mënyrën se si funksionon administrata ekonomike në Shqipëri. QKB është sot një nga shembujt më të qartë të reformave për modernizimin e shërbimeve publike, duke kontribuar në përmirësimin e klimës së biznesit, uljen e burokracisë dhe përafrimin me standardet e Bashkimit European.



Na kontaktoni



0800 80 02



www.qkb.gov.al



Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona nr.33,
Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë

OKB